

Prishtinë 20/ 09/2006

Kodi i ZRrE-së: D\_14\_2006

Nr. i Referencës: ERO/CPD\_R\_06\_07\_06

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Urdhëresën e Autoritetit Rregullativ i Sherbimeve Publike të Kosovës “ARRSHPK” Nr. 13-02/ENQ të datës 8 Nëntor, 2002 Rreth Procedurave dhe Tarifave të përkohshme për konsumatorët e mëdhenj;
4. Kërkesa e konsumatorit nr.2230, të datës 13.06.2006 drejtuar divizionit të furnizimit – departamenti për konsumator të KEK-ut (distrikti – Prizren);
5. Përgjigjen e divizionit të furnizimit – departamenti për konsumator të KEK-ut në kërkesën e konsumatorit nr 2230, të datës 29.06.2006 dhënë konsumatorit;
6. Ankesën e konsumatorit bërë në DMK të ZRRE-së Nr 12/7 2006, të datës 03.08.2006 ku apelohet përgjigja e KEK-ut e datës 29.06. 2006;
7. Rekomandimi i DMK bërë Bordit të ZRrE, në pajtim me Nenin 14.5 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
8. Nenin 18 të Rregullit për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 20.09.2006 morri këtë:

### VENDIM

Ankesa e konsumatorit Skyfter Elshani – Separacioni “Egzoni”, Piranë Prizren **REFUZOHET** për arsye të paraqitura në arsyetim të këtij Vendimi.

### Arsyetimet

1. Konsumatori Skyfter Elshani (Separacioni “Egzoni” Piranë) në ankesën e tijë drejtuar divizionit të furnizimit – departamenti për konsumator, Distrikti Prizren nr. 2230, të datës 13.06.2006 i drejtohet këtij divizioni të KEK-ut me kërkesë për rishqyrtimin e faturimit të fuqisë së angazhuar të rexhistruar në maksigraf. Konsumatori nuk e konteston leximin e drejtë dhe të saktë të maksigrafit, por e kundërshton tarifen e lartë të fuqisë së angazhuar;

2. Me datën 29.06.2006 divizioni i furnizimit – departamenti për konsumator, Distrikti Prizren i përgjigjet konsumatorit në kërkesën e tijë nr 2230. Në këtë përgjigje KEK-u i shpjegon konsumatorit bazen ligjore për tarifen e fuqisë së angazhuar dhe e udhëzon konsumatorin në të drejtën e tijë për të apeluar përgjigjen/vendimin e KEK-ut tek ZRRE;
3. Me datën 03.08.2006 konsumatori apelon përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së. DMK e ZRRE-së e ka rexhistruar ankesën e konsumatorit në rexhistrin e ankesave me nr. 12/7 2006;
4. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatoreve me datën 16.08.2006 ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit nr. 12/7 2006, ka rishikuar dokumentet e ofruara nga konsumatori dhe i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të refuzoi ankesën e konsumatorit nr. 12/7 2006 e cila ankesë apelon përgjigjen e KEK-ut të datës 29.06.2006. Ankesa duhet refuzuar ngase:
  - 4.1. KEK-u ka vepruar në bazë të kornizës ligjore në fuqi, në veqanti ka zbatuar Urdhëresën e ARRSHPK-së Nr. 13-02/ENQ të datës 8 Nëntor, 2002 Rreth Procedurave dhe Tarifave të përkohëshme për konsumatorët e medhenjë, e cila është ende në fuqi;
  - 4.2. KEK-u ka bërë lexim të rregullt dhe të saktë të fuqisë së angazhuar të konsumatorit;
  - 4.3. Ka respektuar afatet e parapara për përgjigje në ankesën e konsumatorit sipas Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
5. Më 20.09.2006 Bordi i ZrreE Ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishqyrtuar të gjitha dokumentet e paraqitura, dhe ka vendosur që **të refuzoj** apelimin e konsumatorit për arsye të paraqitura në Pikën 4 të këtij Vendimi.

#### Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjyqin Komunal të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Kryesusi i Bordit të ZrreE-së

---

Antarët e Bordit:

*T. Kozari*

---

*Merudin Bëri*

---

*M. B. ...*

---

*... ...*

---